

VENDIM
Nr. 595, datë 15.10.2025

PËR PËRCAKTIMIN E PËRBËRJES DHE TË DETYRAVE TË KOMITETIT
KOMBËTAR TË KËRKIM-SHPËTIMIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 4/1, të ligjit nr. 10435, datë 23.6.2011, “Për shërbimin e kërkim-shpëtimit (SAR) në Republikën e Shqipërisë në rast aksidentesh ajrore dhe detare”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Përcaktimin e përbërjes dhe të detyrave të Komitetit Kombëtar të Kërkim-Shpëtimit (në vijim “Komiteti”).

2. Komiteti kryesohet nga Koordinatori Kombëtar i Kërkim-Shpëtimit dhe ka në përbërje këta anëtarë:

- a) komandantin e Forcës Ajrore;
- b) komandantin e Forcës Detare;
- c) komandantin e Forcës Tokësore;
- ç) kryetarin e Qendrës Kombëtare të Kërkim-Shpëtimit;
- d) një përfaqësues të nivelit të lartë nga Ministria e Punëve të Brendshme;
- dh) një përfaqësues të nivelit të lartë drejtues nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë;
- e) një përfaqësues të nivelit të lartë drejtues nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale;
- ë) një përfaqësues të nivelit të lartë drejtues nga Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme;
- f) drejtorin e përgjithshëm të Albcontrol-it;
- g) zëvendës drejtorin e përgjithshëm të Doganave dhe një përfaqësues nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, me funksion menaxherial dhe teknik të fushës në Departamentin Operativo-Hetimor;
- gj) drejtorin e përgjithshëm të Rezervave Materiale të Shtetit;
- h) drejtorin e përgjithshëm të Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile;
- i) drejtorin e Qendrës Kombëtare të Urgjencës Mjekësore;
- j) drejtorin e përgjithshëm të Policisë së Shtetit;
- k) drejtorin ekzekutiv të Autoritetit të Aviacionit Civil;
- l) drejtorin e përgjithshëm të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin;
- ll) drejtorin e përgjithshëm të Autoritetit Kombëtar të Investigimit për Sigurinë e Operimit në Aviacionin Civil;
- m) drejtorin e Drejtorisë së Përgjithshme Detare;
- n) drejtorin e përgjithshëm të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit;
- nj) Sekretarin e Përgjithshëm të Kryqit të Kuq Shqiptar.

3. Komiteti kryen këto detyra:

- a) planifikon dhe zhvillon politika kombëtare në fushën e kërkim-shpëtimit;
- b) harton politika dhe strategji në fushën e kërkim-shpëtimit;
- c) rishikon politikat dhe strategjitë në fushën e kërkim-shpëtimit;
- ç) bashkëpunon me autoritetet dhe organizatat civile apo ushtarake për zhvillimin me efektivitet të politikave e të strategjive të shërbimit të kërkim-shpëtimit (SAR);
- d) monitoron zbatimin e politikave e të strategjive, me qëllim rritjen e efektivitetit të përgjithshëm dhe efikasitetin e shërbimeve SAR;
- dh) promovon politikat dhe programet e sigurisë për të ndihmuar qytetarët të shmangin ose të përballen me situatat në rastet e aksidenteve ajrore e detare;

e) zhvillon kërkimet për planet, politikat, manualët, kërkesat dhe standardet e kërkim-shpëtimit;

ë) orienton politika për trajnimin dhe aftësimin e personelit të përfshirë në operacionet e kërkim-shpëtimit;

f) bashkëpunon me organizata dhe agjenci ndërkombëtare për zhvillimin e politikave dhe aktiviteteve të përbashkëta në fushën e kërkim-shpëtimit.

4. Me qëllim përmbushjen e detyrave, të përcaktuara në pikën 3, të këtij vendimi, kryetari i Komitetit cakton mbledhjet e rregullta periodike, jo më pak se 2 (dy) herë në vit dhe të jashtëzakonshme, sipas rastit në ngjarje madhore, në rast operacionesh masive për aksidentet ajrore e detare.

5. Me miratimin e anëtarëve të Komitetit, sipas nevojës, në mbledhjet e Komitetit ftohen ekspertë të fushës për të dhënë kontributin e tyre në situata të veçanta.

6. Sekretar teknik i Komitetit caktohet një përfaqësues nga Qendra Kombëtare e Kërkim-Shpëtimit.

7. Sekretari teknik i Komitetit kryen këto detyra:

a) siguron organizimin dhe funksionimin efikas të Komitetit;

b) siguron mbështetjen teknike për zhvillimin e takimeve dhe të proceseve të lidhura me funksionimin e Komitetit Kombëtar të Kërkim-Shpëtimit;

c) siguron përgatitjen dhe shpërndarjen e materialeve të agjendës përkatëse për mbledhjen e Komitetit, 5 (pesë) ditë pune përpara takimit;

ç) bashkërendon veprimtarinë midis agjencive dhe institucioneve të përfshira në Komitet;

d) përditëson situatën dhe siguron informacion të saktë për operacionet e kërkim-shpëtimit;

dh) bën dokumentimin e aktivitetit dhe të takimeve të Komitetit.

8. Ngarkohen ministri i Mbrojtjes dhe Komiteti Kombëtar i Kërkim-Shpëtimit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama